

Për zhvillimin e testimit për vlerësues dëmsh në sigurime

Në zbatim të nenit 227 pika 1/dh të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe nenit 7, të Rregullores nr.35, datë 27.03.2019, “Mbi organizimin dhe funksionimin e testimit të njohurive të kandidatëve që aplikojnë për licencë/rinovim licence në AMF”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, njofton të gjithë të interesuarit, se në datën 15 shtator 2021, ora 11.00, do të zhvillohet testimi për vlerësues dëmsh në sigurime.

Në testim do të marrin pjesë të gjithë ata aplikantë që plotësojnë të gjitha kërkesat e Ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 dhe Rregullores nr. 85, datë 03.07.2017.

Për më tepër informacion kontaktoni amf@amf.gov.al.